Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 02-466
Datë 16.11.2016

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 31.10.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për akreditimin e Qendrës Trajnuese të Korporatës Energjetike të Kosovës në Obiliq, për periudhën 3 vjeçare, prej 31. 10. 2016 deri 31. 10. 2019 për këtë kualifikim të aprovuar:

1.1. Instalues Elektrik, niveli i KKK (IV).

Validimi i kualifikimit dhe akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Të krijohet procedurë/politikë e cila parasheh kushtet, kriteret dhe afatet rreth mundësisë së ri-testimit për kandidatët të cilët nuk e kalojnë me sukses modulin/kualifikimin.
- Të krijohet procedurë/politikë e cila parasheh rastet kur dhe si mund të bëhet ndryshimi i përmbajtjes së moduleve, orëve për modul dhe kohëzgjatjes së kualifikimit.
- Dokumenti "Politikat për kandidatët me nevoja të veçanta" duhet të aprovohet dhe të parashihen hapat që merren për trajtimin e kandidatëve me nevoja të veçanta.
- Të përgatitet procedurë/politikë për njohjen e kredive nga institucionet tjera.

(Afati kohor: 01. 02. 2017).

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 31.10.2016, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:
   - Qendrës Trajnuese në Obiliq; dhe
   - AKK.

Nën- kryetari i KD së AKK
Anton Gojani